



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS

MINISTRI

URDHËR

Nr. 252, datë 15/09/2014

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PËRCAKTIMIN E KËRKESAVE
MBI CILËSINË E TË DHËNAVE AERONAUTIKE DHE TË
INFORMACIONIT AERONAUTIK

Në zbatim të Nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit nr. 10040, date. 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar dhe në përputhje me Ligjin Nr.9658, datë 18.12.2006 "Për ratifikimin e Marrëveshjes Shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Shteteve Anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për krijimin e një Zone të Përbashkët të Aviacionit Evropian”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Për përcaktimin e kërkesave mbi cilësinë e të dhënave aeronautike dhe të informacionit aeronautik”.
2. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për zbatimin e këtij Urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në fletoren zyrtare.

Edmond Haxhinasto



**URDHËR****Nr. 252, datë 15.9.2014****PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR PËRCAKTIMIN E KËRKESAVE
MBI CILËSINË E TË DHËNAVE
AERONAUTIKE DHE TË
INFORMACIONIT AERONAUTIK”**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 10 040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në përputhje me ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Europian dhe Shteteve Anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës

së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për krijimin e një zone të përbashkët të Aviacionit Europian”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Për përcaktimin e kërkesave mbi cilësinë e të dhënave aeronautike dhe të informacionit aeronautik”.

2. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I INFRASTRUKTURËS
DHE TRANSPORTIT
Edmond Haxhinasto**

RREGULLORE

PËR PËRCAKTIMIN E KËRKESAVE MBI CILËSINË E TË DHËNAVE AERONAUTIKE DHE TË INFORMACIONIT AERONAUTIK

KAPITULLI I

DISPOZITA TE PËRGJITHSHME

Neni 1

Qellimi

Kjo rregullore përcakton kërkesat mbi cilësinë e të dhënave aeronautike dhe te informacionit aeronautik për sa i përket saktësisë, rezolucionit dhe integritetit.

Neni 2

Fusha e veprimit

Kjo Rregullore do të zbatohet në sistemin tonë, në kuadrin e integritetit në Rrjetin Evropian të Menaxhimit të Trafikut Ajror (RREMTA), për përbërësit dhe procedurat shoqëruese të tyre të përfshira në krijimin, prodhimin, ruajtjen, përdorimin, përpunimin, transferimin dhe shpërndarjen e të dhënave aeronautike dhe informacionit aeronautik.

Ajo do të zbatohet për të dhënat aeronautike dhe informacionin aeronautik te mëposhtem:

- a) Paketën e integruar te informacionit aeronautik siç përcaktohet në nenin 3(7) te kësaj Rregulloreje e vene në dispozicion nga Republika e Shqipërisë, me përjashtim të qarkoreve të informacionit aeronautik;
- b) Të dhënat elektronike të pengesave, ose elementë të tyre, aty ku janë të disponueshme nga Republika e Shqipërisë;
- c) Të dhënat elektronike të terrenit, ose elementë të tyre, aty ku janë të disponueshme nga Republika e Shqipërisë;
- d) Të dhënat e sistemit te informacionit gjeografik te aerodromit, aty ku janë të disponueshme nga Republika e Shqipërisë.

1. Kjo Rregullore do të jetë e zbatueshme për palët në vijim:

1. Ofruesin e shërbimeve të lundrimit ajror;
2. Operatorët e atyre aerodromeve dhe fushave të helikopterëve, për të cilët janë publikuar procedurat e fluturimit sipas rregullave te fluturimit instrumental (RRFI) ose

rregullave të fluturimit vizual special(RRFV) në publikimet e informacionit aeronautik kombëtar;

3. Entet publike ose private që ofrojnë për qëllimet e kësaj Rregulloreje:

- i. Shërbime për krijimin dhe sigurimin e të dhënave të matura;
- ii. Shërbime të dizenjimit të procedurave të fluturimit;
- iii. Të dhëna elektronike të terrenit;
- iv. Të dhëna elektronike të pengesave.

2. Kjo Rregullore do të jetë e zbatueshme deri në momentin kur të dhënat aeronautike dhe/ose informacioni aeronautik vihen në dispozicion të përdoruesit tjetër të interesuar nga ofruesi i shërbimit të informacionit aeronautik.

Në rast të shpërndarjes me anë të mjeteve fizike, kjo Rregullore do të jetë e zbatueshme deri në momentin kur të dhënat aeronautike dhe/ose informacioni aeronautik vihen në dispozicion të organizatës përgjegjëse për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes fizike.

3.1 Në rast të shpërndarjes automatike nëpërmjet përdorimit të një lidhjeje të drejtpërdrejtë elektronike midis ofruesit të shërbimit të informacionit aeronautik dhe entit marrës të të dhënave aeronautike dhe/ose informacionit aeronautik, kjo Rregullore do të jetë e zbatueshme:

- a) Deri në momentin kur përdoruesi tjetër i interesuar të ketë akses dhe të ekstrahojë të dhënat aeronautike dhe/ose informacionin aeronautik të mbajtur nga ofruesi i shërbimit të informacionit aeronautik; ose
- b) Deri në momentin kur të dhënat aeronautike dhe/ose informacioni aeronautik dërgohet nga ofruesi i shërbimit të informacionit aeronautik, në sistemin e përdoruesit të ardhshëm të parashikuar.

Neni 3

Përkufizime

Për qëllime të kësaj Rregulloreje, do të jenë të zbatueshme përkufizimet në Shtojcën I të Udhëzimit të Ministrit të Transporteve Nr. 5 date 03.06.2010 “Kuadri Rregullativ në QVE”. Do të jenë të zbatueshme gjithashtu përkufizimet vijuese:

1. ‘të dhëna aeronautike’ do të thotë një pasqyrim i fakteve, koncepteve apo udhëzimeve aeronautike në mënyrë zyrtare, të përshtatshme për komunikim, interpretim ose përpunim;

2. 'informacion aeronautik' do të thotë informacioni që rezulton nga grumbullimi, analiza dhe formatimi i të dhënave aeronautike;
3. 'cilësia e të dhënave' do të thotë një shkallë ose nivel besimi që të dhënat e siguruara përmbushin kërkesat e përdoruesit të të dhënave në lidhje me saktësinë, rezolucionin dhe integritetin;
4. 'saktësia' do të thotë një shkallë përputhjeje midis vlerës së vlerësuar apo të matur dhe vlerës së vërtetë;
5. 'rezolucioni' do të thotë një numër njësisish apo shifrash me anë të të cilave shprehet apo përdoret një vlerë e matur apo e llogaritur;
6. 'integriteti' do të thotë një shkallë sigurie që një element i të dhënave dhe vlera e tij nuk kanë humbur ose janë ndryshuar që prej krijimit të të dhënave apo ndryshimit të autorizuar;
7. 'pakete e integruar e informacionit aeronautik' (që këtej e tutje IAIP) do të thotë një paketë që konsiston në elementet e mëposhtme:
 - a. Publikimet e informacionit aeronautik (që këtej e tutje AIP), duke përfshirë amendamentet;
 - b. Suplementet e AIP;
 - c. NOTAM-et, siç përcaktohet në pikën 17 dhe buletinet e informacionit para fluturimit;
 - d. Qarkoret e informacionit aeronautik; dhe
 - e. Listat e kontrollit dhe listat e NOTAM-eve të vlefshme;
8. 'të dhënat e pengesave' nënkupton të dhënat lidhur me të gjitha objektet e palevizshme (të përkohshme ose të përhershme) dhe të lëvizshme, ose pjesë të tyre, që ndodhen në një zonë të përcaktuar për lëvizjen në tokë të avioneve ose që shtrihen mbi një sipërfaqe të përcaktuar që ka për qëllim mbrojtjen e avioneve në fluturim;
9. 'të dhënat e terrenit' do të thotë të dhënat mbi sipërfaqen e tokës që përmbajnë tipare natyrore të tilla si malet, kodrat, vargmalet, luginat, trupat ujorë, akull dhe dëborë e përhershme duke përfshirë pengesat;
10. 'të dhënat e sistemit të informacionit gjeografik të aerodromit' do të thotë

- informacioni që pasqyron karakteristikat e standartizuara të aerodromit për një zonë të përcaktuar, duke përfshirë të dhënat gjeo - hapësinore dhe të dhënat mbi të dhënat;
11. 'të dhënat e matura' do të thotë të dhëna gjeo - hapësinore që përcaktohen nga matja ose perlllogaritja;
 12. 'dizenjimi i procedurës' do të thotë kombinimi i të dhënave aeronautike me udhëzimet e veçanta të fluturimit për të përcaktuar procedurat e mbërritjes dhe/ose nisjes instrumentale që sigurojnë standarde të përshtatshme të sigurisë së fluturimit;
 13. 'ofruesi i shërbimit të informacionit aeronautik' do të thotë organizata përgjegjëse për sigurimin e një shërbimi të informacionit aeronautik, i certifikuar në përputhje me Urdhrin e Ministrit të Transporteve Nr. 115 date 23.10.2012 "Për Miratimin e Rregullores mbi Kërkesat e Përbashkëta për Ofrimin e Shërbimeve të Lundrimit Ajror";
 14. 'përdoruesi tjetër i interesuar' do të thotë entiteti që merr informacionin aeronautik nga ofruesi i shërbimit të informacionit aeronautik;
 15. 'lidhje e drejtpërdrejtë elektronike' do të thotë lidhja dixhitale midis sistemeve kompjuterike në mënyrë të tillë që të dhënat mund të transferohen midis tyre pa ndërveprim manual;
 16. 'element i të dhënave' do të thotë një atribut i vetëm i një grupi të plotë të dhënash, të cilit i jepet një vlerë që përcakton statusin e tij aktual;
 17. 'NOTAM' do të thotë një njoftim i shpërndarë me ane të mjeteve të telekomunikacionit që përmban informacion lidhur me vendosjen, gjendjen ose ndryshimin të cdo sistemi, mjeti, shërbimi, procedure ose ngjarje aeronautike, njohja në kohë e të cilave është thelbësore për personelin e lidhur me operimin e fluturimeve;
 18. 'NOTAM dixhital' do të thotë një set të dhënash që përmban informacion të përfshirë në një NOTAM në një format të strukturuar që mund të interpretohet plotësisht nga një sistem kompjuterik i automatizuar pa interpretim njerëzor;
 19. 'krijues i të dhënave' do të thotë një entitet përgjegjës për krijimin e të dhënave;
 20. 'krijimi i të dhënave' do të thotë krijimi i një elementi të ri të dhënash me vlerën e tij përkatëse, modifikimi i vlerës së një elementi ekzistues të të dhënave ose fshirja e një elementi ekzistues të të dhënave;

21. ‘periudha e vlefshmërisë’ do të thotë periudha midis datës dhe orës në të cilën publikohet informacioni aeronautik dhe datën dhe orën në të cilën informacioni pushon se qeni në fuqi;
22. ‘validimi i të dhënave’ do të thotë procesi që siguron që të dhënat përmbushin kërkesat për programin e specifikuar apo përdorimin e interesuar;
23. ‘verifikimi i të dhënave’ do të thotë vlerësimi i të dhënave të dala nga procesi i të dhënave aeronautike për të siguruar korrektësi dhe kompaktësi lidhur me inputet dhe standardet e zbatueshme të të dhënave, si edhe rregullat dhe marrëveshjet e përdorura në atë proces;
24. ‘të dhëna kritike’ do të thotë të dhëna me një nivel integriteti siç përcaktohet në kapitullin 3, Seksioni 3.2 pika 3.2.8(a) e Urdherit të Ministrisë të Transporteve Nr. 81, datë 31.07.2012 ‘Për miratimin e Rregullores mbi Shërbimin e Informacionit Aeronautik’;
25. ‘të dhëna thelbësore’ do të thotë të dhënat me një nivel integriteti siç përcaktohet në Kapitullin 3, Seksioni 3.2 pika 3.2.8(b) e Urdherit të Ministrisë të Transporteve Nr. 81, datë 31.07.2012 ‘Për Miratimin e Rregullores mbi Shërbimin e Informacionit Aeronautik’.

KAPITULLI II

KERKESAT E PERFORMANCËS DHE NDËRVEPRUESHMËRISË

Neni 4

Grupi i të dhënave

Palët e përmendura në nenin 2(2) të kësaj rregulloreje do të sigurojnë të dhëna aeronautike dhe informacion aeronautik në përputhje me specifikimet e grupeve të të dhënave të përshkruara në Shtojcën I të kësaj rregulloreje.

Neni 5

Shkëmbimi i të dhënave

1. Palët e përmendura në nenin 2(2) të kësaj Rregulloreje do të sigurojnë që të dhënat aeronautike dhe informacioni aeronautik i përmendur në nën-paragrafin e dytë të nenit 2(1) të transferohen mes tyre me anë të një lidhjeje të drejtpërdrejtë elektronike.

2. Ofruesi i shërbimeve të lundrimit ajror do të sigurojë që të dhënat aeronautike dhe informacioni aeronautik i përmendur në nën-paragrafin e dytë të nenit 2(1) të kësaj Rregulloreje të transferohen mes tyre në përputhje me kërkesat e formatit të shkëmbimit të të dhënave të përcaktuara në Shtojcën II të kësaj rregulloreje.
3. Republika e Shqipërisë mund të përjashtojë NOTAM-et dixhitale nga formati i shkëmbimit të të dhënave të përmendur në paragrafin 2.
4. Ofruesi i shërbimit të informacionit aeronautik do të sigurojë që të gjitha të dhënat aeronautike dhe informacioni aeronautik që përmbahet në AIP, amendamente të AIP dhe suplemente të AIP të siguruar nga Republika e Shqipërisë të vihen në dispozicion të përdoruesit tjetër të interesuar, minimalisht:
 - a. Në përputhje me kërkesat e publikimit të identifikuar në standardet ICAO-s, të përmendura në pikat 4 dhe 8 të Shtojcës III të kësaj Rregulloreje, përsa kohe ato janë pjesë e kuadrit rregullator në vendin tone;
 - b. Në mënyrë të tillë që të lejojë përmbajtja dhe formati i dokumenteve të jetë i lexueshëm drejtpërdrejtë në ekranin e kompjuterit; dhe
 - c. Në përputhje me kërkesat e formatit të shkëmbimit të të dhënave të përcaktuara në Shtojcën II të kësaj rregulloreje.

Neni 6

Cilësia e të dhënave

1. Republika e Shqipërisë do të sigurojë që ofruesi i shërbimeve të lundrimit ajror të përmbushë kërkesat e cilësisë së të dhënave të përcaktuara në Shtojcën IV, Pjesa A të kësaj rregulloreje, përsa kohe ato janë pjesë e kuadrit rregullator në vendin tone.
2. Në sigurimin të të dhënave aeronautike dhe/ose informacionit aeronautik, palët sipas nenit 2(2) do të përmbushin kërkesat e evidencave të përcaktuara në Shtojcën IV, Pjesa B të kësaj rregulloreje, përsa kohe ato janë pjesë e kuadrit rregullator në vendin tone.
3. Në shkëmbimin e të dhënave aeronautike dhe/ose informacionit aeronautik midis tyre, palët sipas Nenit 2(2), do të vendosin marrëveshje formale në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Shtojcën IV, Pjesa C të kësaj rregulloreje, përsa kohe ato janë pjesë e kuadrit rregullator në vendin tone.

4. Nëse veprojne si krijues të dhënash, palët sipas Nenit 2(2), do të përmbushin kerkesat e krijimit të të dhënave të përcaktuara në Shtojcën IV, Pjesa D të kësaj Rregulloreje, persa kohe ato janë pjesë e kuadrit rregullator në vendin tone.
5. Ofruesi i shërbimit të informacionit aeronautik do të sigurojë që të dhënat aeronautike dhe informacioni aeronautik të siguruar nga krijuesit e të dhënave që nuk i referohen nenit 2(2) të vihen në dispozicion të përdoruesit tjetër të interesuar me cilësi të mjaftueshme për të përmbushur përdorimin e interesuar.
6. Kur veprojne si ent përgjegjës për kërkesë zyrtare për një aktivitet për krijimin e të dhënave, palët sipas Nenit 2(2) do të sigurojnë që:
 - a. Të dhënat janë krijuar, modifikuar ose fshire në përputhje me udhëzimet e tyre;
 - b. Duke respektuar shtojcën IV, Pjesa C të kësaj Rregulloreje, udhëzimet e tyre të krijimit të të dhënave përmbajnë, të paktën:
 - i. Një përshkrim të qartë të të dhënave që duhen krijuar, modifikuar ose fshire;
 - ii. Konfirmimin e entit të cilit duhet t'i dërgohen të dhënat;
 - iii. Datën dhe orën në të cilën do të sigurohen të dhënat;
 - iv. Formatin i raportimit të krijimit të të dhënave që do të përdoret nga krijuesi i të dhënave.
7. Palët sipas Nenit 2(2) do të përmbushin kerkesat e procesit të të dhënave të përcaktuara në Shtojcën IV, Pjesa E të kësaj Rregulloreje, persa kohe ato janë pjesë e kuadrit rregullator në vendin tone.
8. Palët sipas nenit 2(2) do të sigurojnë që mekanizmat për raportimin e gabimeve, informacionit të marre dhe korrigjimit të krijojnë dhe funksionojnë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Shtojcën IV, Pjesa F të kësaj Rregulloreje, persa kohe ato janë pjesë e kuadrit rregullator në vendin tone.

Neni 7

Kompaktësia, përpikmëria dhe performanca personale

1. Aty ku të dhënat aeronautike ose informacioni aeronautik është i duplikuar në AIP -et më shumë se një vendi anëtar të Bashkimit Evropian dhe jo vetëm, ofruesit e shërbimit të

informacionit aeronautik përgjegjës për ato AIP-e do të vendosin mekanizma për të siguruar kompaktësinë midis informacionit të duplikuar.

2. Ofruesi i shërbimit të informacionit aeronautik do të sigurojë që elementet e të dhënave aeronautike dhe informacionit aeronautik të publikuara në AIP-in e Republikës së Shqipërisë që nuk i përmbushin kërkesat e cilësisë së të dhënave të përcaktuara në këtë Rregullore, të tregohen dhe evidentohen.
3. Ofruesi i shërbimit të informacionit aeronautik do të sigurojë që ciklet më aktuale të përditësimit, të zbatueshme për amendimet e AIP dhe suplementet e AIP, të bëhen publikisht të disponueshme.
4. Palët sipas Nenit 2(2) do të sigurojnë që personeli i tyre përgjegjës për detyrat në sigurimin e të dhënave aeronautike ose informacionit aeronautik është në dijeni dhe do të zbatojë:
 - a. Kërkesat për amendamentet e AIP, suplementet e AIP dhe NOTAM në përputhje me standardet e ICAO-s të përmendura në pikat 5, 6 dhe 7 të Shtojcës III të kësaj Rregulloreje, për sa kohë ato janë pjesë e kuadrit rregullator në vendin tone;
 - b. Ciklet e përditësimit të zbatueshme për lëshimin e amendamenteve dhe suplementeve të AIP sipas pikës (a) të këtij paragrafi për zonat për të cilat ata po sigurojnë të dhëna aeronautike ose informacion aeronautik.
5. Duke respektuar Urdhrin e Ministrisë së Transporteve Nr. 115 datë 23.10.2012 “Për Miratimin e Rregullores mbi Kërkesat e Përbashkëta për Ofrimin e Shërbimeve të Lundrimit Ajror”, palët sipas Nenit 2(2) do të sigurojnë që personeli i tyre përgjegjës për detyrat në sigurimin e të dhënave aeronautike ose informacionit aeronautik të jetë i trajnuar në mënyrë të përshtatshme, kompetent dhe i autorizuar për punën që kërkohet të kryejë.

Neni 8

Kriteret e mjeteve dhe programeve kompjuterike (software)

Palët sipas Nenit 2(2) do të sigurojnë që të gjitha mjetet dhe programet kompjuterike të përdorura për të mbështetur krijimin, prodhimin, ruajtjen, përdorimin, përpunimin dhe transferimin e të dhënave aeronautike dhe/ose informacionit aeronautik përputhen me kërkesat e përcaktuara në Shtojcën V të kësaj rregulloreje, për sa kohë ato janë pjesë e kuadrit rregullator në vendin tone.

Neni 9

Mbrojtja e të dhënave

1. Palët sipas Nenit 2(2) do të sigurojnë që të dhënat aeronautike dhe informacioni aeronautik mbrohen në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Shtojcën VI të kësaj Rregulloreje, persa kohe ato janë pjesë e kuadrit rregullator në vendin tonë.
2. Palët sipas Nenit 2(2) do të sigurojnë që të ruhet gjurmueshmëria për secilin element të të dhënave gjatë periudhës së tij të vlefshmërisë dhe për të paktën 5 vjet pas përfundimit të asaj periudhe ose deri 5 vjet pas përfundimit të periudhës së vlefshmërisë për çdo element të të dhënave të llogaritur ose që ka rrjedhur prej tij, cilido të jetë më i vonë.

KAPITULLI III

KERKESAT E MENAXHIMIT TË CILËSISË, SHMANGIES SE RREZIQEVE DHE SIGURISË

Neni 10

Kriteret e menaxhimit

1. Duke respektuar Urdhrin e Ministrit të Transporteve Nr. 115 datë 23.10.2012 “Për Miratimin e Rregullores mbi Kërkesat e Përbashkëta për Ofrimin e Shërbimeve të Lundrimit Ajror”, palët sipas Nenit 2(2) do të zbatojnë dhe do të mbajnë një sistem të menaxhimit të cilësisë që të mbulojë aktivitetet e sigurimit të të dhënave të tyre aeronautike edhe informacionit aeronautik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Shtojcën VII, Pjesa A të kësaj rregulloreje, persa kohe ato janë pjesë e kuadrit rregullator në vendin tonë.
2. Palët sipas Nenit 2(2) do të sigurojnë që sistemi i menaxhimit të cilësisë sipas paragrafit 1 të këtij neni përcakton procedurat për të përmbushur objektivat e menaxhimit të shmangies së rreziqeve(safety) të përcaktuara në Shtojcën VII, Pjesa B, të kësaj Rregulloreje dhe objektivat e menaxhimit të sigurisë(security) të përcaktuara në Shtojcën VII, Pjesa C të kësaj Rregulloreje, persa kohe ato janë pjesë e kuadrit rregullator në vendin tonë.
3. Palët sipas Nenit 2(2) do të sigurojnë që çdo ndryshim në sistemet ekzistuese përmendur në nën-paragrafin e parë të Nenit 2(1) ose futja e sistemeve të reja të paraprihet nga një vlerësim i shmangies së rrezikut (safety), duke përfshirë identifikimin e pengesave, vlerësimin dhe zbutjen e riskut, drejtuar palët përkatëse.
4. Gjatë vlerësimit të riskut(safety), kërkesat sipas Nenit 7(3), Shtojca I, Shtojca II dhe pikat 1 dhe 2 të Pjesës A të Shtojcës IV të kësaj Rregulloreje, persa kohe ato janë pjesë e kuadrit rregullator në vendin tonë, do të konsiderohen si kërkesa të shmangies së rrezikut(safety) dhe do të merren në konsideratë, si një minimum.

KAPITULLI IV

VLERESIMI I KONFORMITETIT DHE KERKESA TË TJERA

Neni 11

Konformiteti ose përshtatshmëria për përdorimin e pjesëve përbërëse

Përpara lëshimit të deklaratave të konformitetit ose përshtatshmërisë Komisionit Evropian (KE) për përdorim sipas Nenit 5 të Urdhërit i Ministrisë të Transporteve Nr. 8, datë 03.06.2010 “Për Ndërveprimin në Rrjetin Evropian të Menaxhimit të Trafikut Ajror”, prodhuesit e elementeve përbërëse të sistemeve sipas nën-paragrafit të parë të Nenit 2(1) të kësaj Rregulloreje, ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar siç është vendosur në BE, do të vlerësojnë përshtatshmërinë për përdorim të atyre elementeve përbërëse në përputhje me kërkesat e përcaktuara në shtojcën VIII të kësaj Rregulloreje, persa kohe ato janë pjesë e kuadrit rregullator në vendin tone.

Neni 12

Verifikimi i sistemeve

1. Ofruesi i shërbimeve të lundrimit ajror që mund të tregojë ose ka treguar se ai përmbush kushtet e përcaktuara në Shtojcën IX do të kryejë një verifikim të sistemeve sipas nën-paragrafit të parë të Nenit 2(1) në përputhje me kriteret e përcaktuara në Shtojcën X, Pjesa A të kësaj Rregulloreje, persa kohe ato janë pjesë e kuadrit rregullator në vendin tone.
2. Ofruesi i shërbimeve të lundrimit ajror që nuk mund të tregojë se ai përmbush kushtet e përcaktuara në Shtojcën IX do t'i nënkontrakttojë një organi të njoftuar verifikimin e sistemeve sipas nën-paragrafit të parë të Nenit 2(1). Ky verifikim do të kryhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Shtojcën X, Pjesa B të kësaj Rregulloreje, persa kohe ato janë pjesë e kuadrit rregullator në vendin tone.

Neni 13

Kerkesa Shtesë

Palët sipas Nenit 2(2)(b) dhe (c) do të:

- a) sigurojnë certifikatën e sigurimit për personelin e tyre përgjegjës për detyra në krijimin, prodhimin, ruajtjen, përdorimin, përpunimin, transferimin dhe shpërndarjen e të dhënave aeronautike ose informacionit aeronautik, në mënyrën e duhur;
- b) sigurojnë që personeli i tyre përgjegjës për detyra në sigurimin e të dhënave aeronautike ose informacionit aeronautik të informohet siç duhet mbi kërkesat e përcaktuara në këtë Rregullore;

- c) zhvillojnë dhe përditësojnë manuale operimi që përmbajnë të gjithë informacionin dhe udhëzimet e nevojshme për të mundësuar që personeli i tyre përgjegjës për detyra në sigurimin e të dhënave aeronautike ose informacionit aeronautik të zbatojë këtë Rregullore;
- d) sigurojnë që manualët sipas pikës (c) të jenë të disponueshme dhe të përditësuara dhe që përditësimi dhe shpërndarja e tyre t'i nënshtrohet një administrimi të përshtatshëm lidhur me cilësinë dhe konfigurimin e dokumentacionit;
- e) sigurojnë që metodat e tyre të punës dhe procedurat e operimit të jenë në përputhje me këtë Rregullore.

KAPITULLI V

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 14

Dispozita kalimtare

1. Të dhënat aeronautike dhe informacioni aeronautik publikuar përpara 01/07/2013 dhe që nuk janë ndryshuar do të përshtaten me këtë Rregullore brenda datës 30/06/2017.

SHTOJCA I

SPECIFIKIMET E SETEVE TË TË DHËNAVE SIPAS NENIT 4

PJESA A

IAIP, te dhenat e sistemit te informacionit gjeografik te aerodromit dhe te dhenat elektronike te pengesave

- 1) Të dhënat aeronautike dhe informacionit aeronautik sipas pikave (a), (b) dhe (d) të Nën paragrafit të dytë të Nenit 2(1) do të sigurohen sipas një specifikimi të përbashkët të grupit të të dhënave që do të:
 - a. jetë i dokumentuar:
 - duke përdorur Gjuhën e Unifikuar të Modelimit (UML), specifikuar në dokumentin sipas pikës 13 të Shtojcës III të kësaj Rregulloreje, në formën e diagrameve të kategorizuara dhe përcaktimeve përkatëse për kategori, attribute, terma dhe listat e vlerave, ose

- duke përdorur një katalog karakteristikash të përcaktuar në përputhje me standardin ISO sipas pikës 25 të Shtojcës III të kësaj Rregulloreje, persa kohe është pjesë e kuadrit rregullator në vendin tonë;
- b. përcaktojë, si elemente individuale të të dhënave, çdo karakteristikë aeronautike për të cilën kërkohet publikimi i informacionit në përputhje me standardet ICAO-s sipas pikës 10 të Shtojcës III të kësaj Rregulloreje dhe dokumentit EUROCAE sipas pikës 24 të Shtojcës III të kësaj Rregulloreje, persa kohe ato janë pjesë e kuadrit rregullator në vendin tonë;
- c. sigurojë për çdo karakteristikë përcaktimin e vlerave të saj të lejueshme në formën e një lloji të dhënash, një seri vlerash ose listë me numra;
- d. përfshijë përcaktimin e një modeli të përkohshëm, bazuar në UTC, që mund të shprehë ciklin jetësor të plotë të një karakteristike aeronautike:
 - nga data dhe ora e krijimit në datën dhe orën e tërheqjes së përhershme,
 - duke përfshirë ndryshimet e përhershme që krijojnë linja të reja standarde për atë karakteristikë;
- e. përfshijë përcaktimin e rregullave që mund të kufizojnë vlerat e mundshme të tipareve të karakteristikave ose ndryshimin e përkohshëm të këtyre vlerave. Kjo do të përfshijë, të paktën:
 - kufizime që imponojnë saktësi, rezolucion dhe integritet për të dhëna pozicionale (horizontale dhe vertikale),
 - kufizime që imponojnë përpikmërinë e të dhënave;
- f. zbatojnë një marrëveshje emërtimi për tiparet, atributet dhe termat, që shmang përdorimin e shkurttimeve;
- g. bazohet për përshkrimin e elementeve gjeometrike (pika, vijë e lakuar, sipërfaqja) në standardin ISO sipas pikës 14 të Shtojcës III të kësaj Rregulloreje, persa kohe është pjesë e kuadrit rregullator në vendin tonë;

- h. bazohet për përshkrimin e informacionit të metadata në standardin ISO sipas pikës 15 të Shtojcës III të kësaj Rregulloreje, persa kohe është pjesë e kuadrit rregullator në vendin tone.;
 - i. përfshijë elementët e meta të dhënave të listuar në shtojcën I, Pjesa C të kësaj Rregulloreje, persa kohe është pjesë e kuadrit rregullator në vendin tone..
- 2) Lidhur me standardet ISO, certifikata përkatëse e lëshuar nga një organizatë e akredituar sipas rregullave, do të konsiderohet një mjet i mjaftueshëm përmbushës. Palët sipas Nenit 2(2) do të pranojnë paraqitjen e dokumentacionit lidhur me certifikimin tek autoriteti mbikëqyrës kombëtar me kërkesë të këtij të fundit.

PJESA B

Grupe të dhënash elektronike për terrenin

Të dhënat elektronike për terrenin sipas pikës (c) të Nën-paragrafit të dytë të Nenit 2(1) do të:

- a. sigurohen në mënyrë dixhitale në përputhje me standardet e ICAO-s sipas pikës 9 dhe 12 të Shtojcës III të kësaj Rregulloreje, persa kohe ato janë pjesë e kuadrit rregullator në vendin tone;
- b. përfshijnë elementët e meta të dhënave të listuar në Shtojcën I, Pjesa C të kësaj Rregulloreje, persa kohe ato janë pjesë e kuadrit rregullator në vendin tone.

PJESA C

Metadata

Metadata (te dhëna mbi te dhëna) për specifikimet e seteve të të dhënave të përcaktuara në Pjesën A dhe Pjesën B do të përfshijnë të paktën elementët vijues:

- a. krijuesin e të dhënave;
- b. amendamentet e të dhënave;
- c. personat dhe organizatat që kanë ndërvepruar me të dhënat dhe kur;
- d. të dhënat e çdo validimi dhe verifikimi të kryer të të dhënave;
- e. data dhe ora e hyrjes në përdorim të të dhënave;
- f. për të dhëna gjeo-hapësinore:

- modelin e referencës së gjeoidit të përdorur,
- sistemin e koordinatave të përdorur;

g. për të dhëna numerike:

- saktësia statistike e matjes ose teknika e llogaritjes së përdorur,
- rezolucioni,
- niveli i besueshmërisë siç kërkohet nga standardet ICAO-s sipas pikave 1 dhe 12 të Shtojcës III të kësaj Rregulloreje dhe në standarde të tjera të ICAO-s, persa kohe ato janë pjesë e kuadrit rregullator në vendin tone;

h. detaje të çfarëdo funksioni të aplikuar nëse të dhënat i janë nënshtruar një konvertimi/transformimi;

i. detaje të çfarëdo kufizimi mbi përdorimin e të dhënave.

SHTOJCA II

KERKESAT E FORMATIT TË SHKËMBIMIT TË TË DHËNAVE AERONAUTIKE SIPAS NENIT 5

PJESA A

IAIP, të dhënat e sistemit të informacionit gjeografik të aerodromit dhe të dhënat elektronike për pengesat

- 1) Të dhënat aeronautike dhe informacioni aeronautik sipas pikave (a), (b) dhe (d) të nënparagrafit të dytë të nenit 2(1) do të strukturohen në përputhje me një specifikim të përbashkët, i cili do të:
 - përdorë specifikimet e gjuhës së kodifikimit të zgjeruar (XML) siç përcaktohet në standardin ISO sipas Shtojcës III të kësaj rregulloreje pika 17 për kodifikimin e të dhënave, persa kohe është pjesë e kuadrit rregullator në vendin tone.
 - shprehet në formën e një skeme XML; gjithashtu, një skematron siç përcaktohet në standardin ISO sipas pikës 19 të Shtojcës III të kësaj Rregulloreje mund të përdoret për të shprehur rregullat e punës,
 - mundësojë shkëmbimin e të dhënave qoftë për tiparet individuale ashtu edhe për tiparet e seteve,

- mundësojë shkëmbimin e informacioneve bazë si rezultat i ndryshimeve të përhershme,
 - strukturohet në përputhje me tiparet, atributet dhe termat e përcaktimit të setit të të dhënave përshkruar në Shtojcën I, Pjesa A të kësaj Rregulloreje; rregullat e kodifikimit do të dokumentohen,
 - zbatohet rreptësisht listat numerike të vlerave dhe gamën e vlerave të përcaktuar për çdo atribut në setin e të dhënave,
 - përputhet me specifikimet e gjuhës së kodifikimit të gjeografisë (GML), siç përcaktohet në referencën sipas pikës 18 të Shtojcës III të kësaj Rregulloreje, për kodifikimin e informacionit gjeografik.
- 2) Lidhur me standardet ISO, certifikata përkatëse e lëshuar nga një organizatë e akredituar, do të konsiderohet si një mjet i mjaftueshëm përmbushës. Palët sipas nenit 2(2) do të pranojnë paraqitjen e dokumentacionit lidhur me certifikimin tek autoriteti mbikëqyrës kombëtar me kërkesë të këtij të fundit.

PJESA B

Të dhënat elektronike të terrenit

- 1) Të dhënat elektronike të terrenit sipas pikës (c) të Nën-paragrafit të dytë të Nenit 2(1) do të sigurohen në një format të përbashkët sipas standardeve ISO në përputhje me pikat 14 deri tek 18 e Shtojcës III të kësaj Rregulloreje, persa kohe ato janë pjesë e kuadrit rregullator në vendin tonë.
- 2) Lidhur me standardet ISO, certifikata përkatëse e lëshuar nga një organizatë e akredituar, do të konsiderohet si një mjet i mjaftueshëm përmbushës. Palët sipas Nenit 2(2) do të pranojnë zbulimin e dokumentacionit lidhur me certifikimin tek autoriteti mbikëqyrës kombëtar me kërkesë të këtij të fundit.

SHTOJCA III

DISPOZITAT NË NENE DHE SHTOJCA

- 1) Kapitulli 3, Seksioni 3.2 (Sistemi i cilësisë) i Urdherit të Ministrit Nr.81 datë 31.07.2012 “Për Miratimin e Rregullores mbi Sherbimin e Informacionit Aeronautik”.
- 2) Kapitulli 3, Seksioni 3.7.1 (sistemi horizontal i referencës) i Urdherit të Ministrit Nr.81 datë 31.07.2012 “Për Miratimin e Rregullores mbi Sherbimin e Informacionit Aeronautik”.

- 3) Kapitulli 3, Seksioni 3.7.2 (sistemi vertikal i referencës) i Urdherit të Ministrit Nr.81 date 31.07.2012 “Per Miratimin e Rregullores mbi Sherbimin e Informacionit Aeronautik”.
- 4) Kapitulli 4 (Publikimet e Informacioneve Aeronautike (AIP)) i Urdherit të Ministrit Nr.81 date 31.07.2012 “Per Miratimin e Rregullores mbi Sherbimin e Informacionit Aeronautik”.
- 5) Kapitulli 4, Seksioni 4.3 (Specifikime për Ndryshimet e AIP) i Urdherit të Ministrit Nr.81 date 31.07.2012 “Per Miratimin e Rregullores mbi Sherbimin e Informacionit Aeronautik”.
- 6) Kapitulli 4, Seksioni 4.4 (Specifikime për Shtesat e AIP) i Urdherit të Ministrit Nr.81 date 31.07.2012 “Per Miratimin e Rregullores mbi Sherbimin e Informacionit Aeronautik”.
- 7) Kapitulli 5 (NOTAM) i Urdherit të Ministrit Nr.81 date 31.07.2012 “Per Miratimin e Rregullores mbi Sherbimin e Informacionit Aeronautik”.
- 8) Kapitulli 6, Seksioni 6.2 (Sigurimi i informacionit me kopje shkresore) i Urdherit të Ministrit Nr.81 date 31.07.2012 “Per Miratimin e Rregullores mbi Sherbimin e Informacionit Aeronautik”.
- 9) Kapitulli 10, Seksioni 10.2 (kriteret numerike të mbulimit dhe të të dhënave mbi terrenin dhe pengesat) i Urdherit të Ministrit Nr.81 date 31.07.2012 “Per Miratimin e Rregullores mbi Sherbimin e Informacionit Aeronautik”.
- 10) Aneksi 1 (Përmbajtja e Publikimit të informacionit Aeronautik (AIP) i Urdherit të Ministrit Nr.81 date 31.07.2012 “Per Miratimin e Rregullores mbi Sherbimin e Informacionit Aeronautik”.
- 11) Aneksi 7 (Kriteret cilësore të të dhënave aeronautike) i Urdherit të Ministrit Nr.81 date 31.07.2012 “Per Miratimin e Rregullores mbi Sherbimin e Informacionit Aeronautik”.
- 12) Aneksi 8 (Kriteret mbi të dhënat e terrenit dhe pengesave) i Urdherit të Ministrit Nr.81 date 31.07.2012 “Per Miratimin e Rregullores mbi Sherbimin e Informacionit Aeronautik”.
- 13) Specifikimet e Gjuhës së Modelimit të Unifikuar (UML) nga Grupi i Menaxhimit të Objektivit Versioni 2.1.1.
- 14) Organizata Ndërkombëtare për Standardizim, ISO 19107:2003 — Informacion Gjeografik — skema hapësinore (Botimi 1 — 8.5.2003).

- 15) Organizata Ndërkombëtare për Standardizim, ISO 19115:2003 — Informacion Gjeografik — Meta të dhënat (Botimi 1 — 8.5.2003 [Corrigendum Cor 1:2006 5.7.2006]).
- 16) Organizata Ndërkombëtare për Standardizim, ISO 19139:2007 — Informacion Gjeografik — Meta të dhënat — XML zbatimi i skemës (Botimi 1 — 17.4.2007).
- 17) Organizata Ndërkombëtare për Standardizim, ISO 19118:2005 — Informacion Gjeografik — Kodifikimi (Botimi 1 — 17.3.2006 ISO/CD 19118 Botimi 2 — 9.7.2007 [Faza e Komitetit]).
- 18) Organizata Ndërkombëtare për Standardizim, ISO 19136:2007 — Informacion Gjeografik — Gjuha e Markimit Gjeografik (GMI.) (Botimi 1 — 23.8.2007).
- 19) Organizata Ndërkombëtare për Standardizim, ISO/IEC 19757-3:2006 — Teknologjia e informacionit — Gjuhët e Përcaktimit Skematik të Dokumenteve (DSDL) — Pjesa 3: miratim i bazuar në rregulla — Skematroni (Botimi 1 — 24.5.2006).
- 20) ICAO Doc 9674-AN/946 — Sistemi Botëror Gjeodezik — 1984 Manuali (Botimi i Dytë — 2002).
- 21) Kapitulli 7, Seksioni 7.3.2 (Algoritmi i Kontrollit Ciklik të Teprisë (CRC)) i ICAO Doc 9674-AN/946 — Sistemi Botëror Gjeodezik — 1984 (WGS-84) Manual (Botimi i Dytë — 2002).
- 22) Organizata Ndërkombëtare për Standardizim, ISO/IEC 17799:2005 — Teknologjia e informacionit — Teknikat e Sigurisë — Kodi i Praktikës për Administrimin e Sigurisë së Informacionit (Botimi 2 — 10.6.2005).
- 23) Organizata Ndërkombëtare për Standardizim, ISO 28000:2007: — Specifikime për sistemet e administrimit të sigurisë për zinxhirin e furnizimit (Botimi 1 — 21.9.2007 nën shqyrtim, për tu zëvendësuar nga Botimi 2 data objektiv 31.1.2008 [Në fazën investiguese]).
- 24) EUROCAE ED-99A, Kriteret të Përdoruesit për Informacionet e Hartave të Aerodromit (Tetor 2005).
- 25) Organizata Ndërkombëtare për Standardizim, ISO 19110:2005 — Informacion Gjeografik — Metodologjia për Katalogimin e Tipareve (Botimi 1).

SHTOJCA IV

KERKESAT E CILËSISË SË TË DHËNAVE SIPAS NENEVE 6 DHE 7

PJESA A

Kerkesat e cilësisë së të dhënave

- 1) Kerkesat e cilësisë së të dhënave për çdo element të të dhënave brenda fushës së të dhënave aeronautike edhe informacionit aeronautik sipas paragrafit të dytë të Nenit 2(1) do të jenë siç janë përcaktuar nga standardet e ICAO-s sipas Shtojcës III pika 11 dhe standarde të tjera të ICAO-s duke respektuar pikën 2 të kësaj Shtojce, përse kohe ato janë pjesë e kuadrit rregullator në vendin tone..
- 2) Kerkesat e cilësisë së të dhënave për një element të të dhënave brenda fushës së të dhënave aeronautike dhe informacionit aeronautik sipas paragrafit të dytë të nenit e 2(1) do të përcaktohen në bazë të një vlerësimi sigurie të përdorimeve të parashikuara të elementit të të dhënave ku:
 - a. Një element i të dhënave nuk përcaktohet nga standardet e cilësisë së të dhënave sipas ICAO-s sipas pikës 11 të Shtojcës III të kësaj Rregulloreje dhe standardeve të tjera të ICAO-s, përse kohe ato janë pjesë e kuadrit rregullator në vendin tone; ose
 - b. Kerkesat e cilësisë së të dhënave për një element të të dhënave nuk përmbushen nga standardet e cilësisë së të dhënave të ICAO-s sipas pikës 11 të Shtojcës III të kësaj Rregulloreje dhe standarde të tjera të ICAO-s, përse kohe ato janë pjesë e kuadrit rregullator në vendin tone..
- 3) Kerkesat e cilësisë së të dhënave për elementët e të dhënave sipas pikës 2 do të zhvillohen në përputhje me një proces të standardizuar që përshkruan metodologjinë për prejardhjen dhe miratimin e këtyre kerkesave përpara publikimit, duke marrë mirë parasysh ndikimin e mundshëm mbi dispozitat përkatëse të ICAO-s.
- 4) Aty ku një element i të dhënave ka më shumë se një përdorim të parashikuar, vetëm kerkesat më rigorozet e cilësisë së të dhënave, që rrjedhin nga vlerësimi i sigurisë sipas pikës 2, do të aplikohen për të.
- 5) Kerkesat e cilësisë së të dhënave do të përcaktohen për çdo element të të dhënave brenda fushës së të dhënave aeronautike dhe informacionit aeronautik sipas nën-paragrafit të dytë të nenit 2(1) të mbulojnë si vijon:
 - a. Saktësia dhe rezolucioni i të dhënave;

b. Niveli i integritetit të të dhënave;

c. Aftësia për të përcaktuar origjinën e të dhënave;

d. Niveli i sigurimit që të dhënat janë të disponueshme për përdoruesin e interesuar përpara datës dhe orës së futjes së tyre në përdorim dhe që të mos fshihen përpara kësaj date/ore.

6) Do të përcaktohen të gjithë elementët e të dhënave që nevojiten për të mbështetur çdo set të dhënash për zbatim dhe/ose një nën-grup të vlefshëm të setit të të dhënave.

PJESA B

Kerkesat e evidencave

Do të jepen argumente dhe evidenca për të treguar se:

a. Kerkesat e saktësisë dhe rezolucionit janë në përputhje me krijimin e të dhënave dhe mbahen deri në publikim për përdoruesin tjetër të interesuar, duke përfshirë, sa herë që rezolucioni i një elementi të të dhënave zvogëlohet ose ndryshohet, ose të dhënat përkthehen në një njësi matëse ose sistem koordinatash të ndryshëm;

b. Historia e origjinës dhe e ndryshimit për çdo element të të dhënave regjistrohet dhe është e disponueshme për kontroll;

c. Të dhënat aeronautike ose informacioni aeronautik janë të plota apo është deklaruar mungesa e ndonjë elementi;

d. Të gjithë proceset e krijimit, prodhimit, ruajtjes, përdorimit, përpunimit, transferimit ose shpërndarjes së të dhënave të përdorur për çdo element të të dhënave janë përcaktuara dhe të përshtatshme për nivelin e caktuar të integritetit të elementit të të dhënave;

e. Proceset e miratimit dhe verifikimit të të dhënave janë të përshtatshme për nivelin e caktuar të integritetit të elementit të të dhënave;

f. Proceset e të dhënave manuale apo gjysmë automatike kryhen nga staf i trajnuar dhe i kualifikuar, me role dhe përgjegjësi qartësisht të përcaktuara që janë të regjistruara në sistemin e cilësisë së organizatës;

g. Të gjitha mjetet dhe/ose softueri i përdorur për të mbështetur ose zbatuar proceset janë miratuar si të përshtatshme me qëllimin, në përputhje me Shtojcën V të kësaj Rregulloreje;

h. Një proces veprimi efektiv për raportimin e gabimeve, matjen dhe korrigjimin është në funksionim, në përputhje me Pjesën F të kësaj Rregulloreje.

PJESA C

Marrëveshjet formale

Marrëveshjet formale duhet të përfshijnë minimalisht përmbajtjen, sic vijon:

- a. Fushën e të dhënave aeronautike ose informacionit aeronautik që do të sigurohet;
- b. Kerkesat e saktësisë, rezolucionit dhe integritetit për çdo element të caktuar të të dhënave;
- c. Metodat e kërkuara për të treguar që të dhënat e siguruara janë në përputhje me kerkesat e specifikuar;
- d. Natyra e veprimit që do të ndërmerret në rast të zbulimit të një gabimi ose pasaktësie të dhënash në çfarëdolloj të dhënash të siguruara;
- e. Kriteret minimale për njoftimin e ndryshimit të të dhënave si vijon:
 - Kriteret për përcaktimin e afatit kohor të të dhënave të siguruara në bazë të rendesise operacionale apo të sigurisë së ndryshmit,
 - Çdo lloj njoftimi paraprak i ndryshimeve të pritura,
 - Mjetet për tu pershtatur për njoftimin;
- f. Pala përgjegjëse për dokumentimin e ndryshimit të të dhënave;
- g. Mjetet për të zgjidhur çdo dyshim potencial të shkaktuar në rastin e përdorimit të formateve të ndryshme për të shkëmbyer të dhëna aeronautike ose informacion aeronautik;
- h. Çdo kufizim për përdorimin e të dhënave;
- i. Kerkesat për hartimin e raporteve të cilësisë nga siguruesit e të dhënave për të lehtësuar verifikimin e cilësisë së të dhënave nga përdoruesit e të dhënave;
- j. Kerkesat e metadatave;
- k. Kerkesat e kontingjencës lidhur me vazhdimësinë e sigurimit të të dhënave.

PJESA D

Krijimi i të dhënave

- 1) Matja e të dhënave të mjeteve të radio-lundrimit dhe krijimi i të dhënave të llogaritura ose të derivuara, koordinatat e të cilave janë publikuar në AIP do të kryhet në përputhje me standardet e duhura dhe të paktën në përputhje me dispozitat e ICAO-s sipas pikës 20 të Shtojcës III të kësaj Rregulloreje, për sa kohë ato janë pjesë e kuadrit rregullator në vendin tone..
- 2) Të gjitha të dhënat e matura do të kenë referencë sistemin WGS-84 siç specifikohet në dispozitat e ICAO-s sipas pikës 2 të Shtojcës III të kësaj Rregulloreje, për sa kohë ato janë pjesë e kuadrit rregullator në vendin tone..
- 3) Një model gjeoid, i mjaftueshëm për të përmbushur dispozitat e ICAO-s sipas pikës 3 të shtojcës III dhe kriteret e cilësisë për të dhënat aeronautike dhe informacionin aeronautik të përcaktuara në Shtojcën IV, do të përdoren në mënyrë që të gjitha të dhënat vertikale (të matura, llogaritura ose derivuara) mund të shprehën në lidhje me nivelin mesatar të detit nëpërmjet Modelit Gravitacional të Tokës 1996. Një 'gjeoid' ka kuptimin e sipërfaqes ekuipotenciale në fushën e gravitetit të Tokës, që përputhet me nivelin mesatar të detit që të që shtrihet në vazhdimësi nëpër kontinente.
- 4) Të dhëna e matura, të llogaritura apo të derivuara do të mbahen gjatë gjithë jetës së çdo elementi të të dhënave.
- 5) Të dhënat e matura të kategorizuara si kritike ose thelbësore do t'i nënshtrohen një analize të plotë fillestare, dhe më pas do të monitorohen minimalisht për ndryshime në bazë vjetore. Aty ku vërehen ndryshime, do të maten përsëri atë dhënat përkatëse.
- 6) Do të përdoren teknikat vijuese të sigurimit dhe ruajtjes së të dhënave elektronike të matjes:
 - a. Koordinatat e pikave të referencës do të regjistrohen në pajisjet e matjeve me anë të transferimit të të dhënave dixhitale;
 - b. Matjet në fushë do të ruhen në mënyrë dixhitale;
 - c. Të dhënat e papërpunuara do të transferohen në mënyrë dixhitale dhe do të vendosen në softuerin e përpunimit.
- 7) Të gjitha të dhënat e matura të kategorizuara si kritike do t'i nënshtrohen matjeve të mjaftueshme shtesë për të identifikuar gabimet e matjeve që nuk dallohen nga një matje e vetme.

- 8) Të dhënat aeronautike dhe informacioni aeronautik do të validohen dhe verifikohen përpara përdorimit duke derivuar apo llogaritur të dhëna të tjera.

PJESA E

Kerkesat e përpunimit të të dhënave

- 1) Në rast se procese ose pjesë të proceseve të përdorura në krijimin, prodhimin, ruajtjen, përdorimin, përpunimin, transferimin dhe shpërndarjen e të dhënave aeronautike dhe informacioni aeronautik i nënshtrohen automatizimit ato do të jenë:
 - a. Të automatizuara në një nivel proporcional me kontekstin e procesit të të dhënave;
 - b. Të automatizuara për të përmirësuar caktimin dhe ndërveprimin e njeriut me makinën për të arritur një shkallë të lartë të përfitimeve të sigurisë dhe cilësisë së procesit;
 - c. Të planifikuara për të shmangur futjen e gabimeve të të dhënave;
 - d. Të planifikuara për të dalluar gabimet në të dhëna të marra/të regjistruara.
- 2) Në rast se të dhënat aeronautike dhe informacioni aeronautik futet në mënyrë manuale, ai do t'i nënshtrohet një verifikimi të pavarur për të identifikuar çdo gabim që mund të jetë futur.

PJESA F

Kerkesat e raportimit dhe korrigjimit të gabimeve

Mekanizmat veprues të raportimit të gabimeve, matjes dhe korrigjimit do të sigurojnë që:

- a. Problemet e identifikuar gjatë krijimit, prodhimit, ruajtjes, përdorimit dhe përpunimit të të dhënave aeronautike dhe informacionit aeronautik, ose ato të identifikuar nga përdoruesit pas publikimit, regjistrohen dhe raportohen tek ofruesi i shërbimit të informacionit aeronautik;
- b. Të gjitha problemet lidhur me të dhënat aeronautike dhe informacionin aeronautik analizohen nga ofruesi i shërbimit të informacionit aeronautik dhe përcaktohen veprimet e nevojshme korrigjuese;
- c. Të gjitha gabimet, mospërputhjet dhe anomalitë e dalluara në informacionin kritik dhe thelbësor aeronautik dhe të të dhënave aeronautike zgjidhen në mënyrë urgjente;
- d. Përdoruesit e prekur të të dhënave paralajmërohen për gabimet nga ofruesi i shërbimit të

informacionit aeronautik me mjetet më efektive, duke marrë parasysh nivelin e integritetit të të dhënave aeronautike dhe informacionit aeronautik dhe duke përdorur kriteret e njoftimit siç është rënë dakord në marrëveshjet formale në përputhje me Shtojcën IV, Pjesa C pika (d) të kësaj Rregulloreje ,përsa kohe ato janë pjesë e kuadrit rregullator në vendin tonë.;

- e. Lehtësohet dhe inkurajohet informacioni për gabimet e të dhënave nga përdoruesit dhe ofrues të tjerë të të dhënave aeronautike dhe informacionit aeronautik;
- f. Përqindjet e gabimit për të dhënat aeronautike dhe informacionin aeronautik regjistrohen në çdo rast kur të dhënat aeronautike dhe informacioni aeronautik transferohet midis palëve sipas Nenit 2(2) të kësaj Rregulloreje;
- g. Përqindjet e gabimit për ato gabime të dalluara përpara transferimit dhe atyre të raportuara pas transferimit mund të identifikohen në mënyrë të veçantë.

SHTOJCA V

KERKESAT E MJETEVE DHE PROGRAMEVE KOMPJUTERIKE (SOFTWARE) SIPAS NENIT 8

- 1) Mjetet e përdorura për të mbështetur ose automatizuar proceset e të dhënave aeronautike dhe informacionit aeronautik do të përmbushin kriteret e pikave 2 dhe 3, ku mjeti:
 - Ka potencialin për të krijuar gabime në elemente kritike dhe thelbësore të të dhënave,
 - Është mjeti i vetëm për dallimin e gabimeve në elemente kritike dhe thelbësore të të dhënave,
 - Është mjeti i vetëm për dallimin e mospërputhjeve midis versioneve të shumta të të dhënave të regjistruara në mënyrë manuale.
- 2) Për mjetet sipas pikës 1, kriteret e performancës, funksionimit dhe integritetit, do të përcaktohen për të siguruar që mjeti kryen funksionin e tij brenda procesit të të dhënave pa ndikuar negativisht në cilësinë e të dhënave aeronautike dhe informacionit aeronautik.
- 3) Mjetet e përmendura në pikën 1 do të validohen dhe verifikohen kundrejt kërkesave sipas pikës 2.
- 4) Mjetet e përmendura në pikën 1, që janë zbatuar plotësisht ose pjesërisht në softuere, do të përmbushin kërkesat shtesë si vijon:
 - Kërkesat e programit kompjuterik do të deklarohen në mënyrë korrekte çfarë kërkohet nga programi kompjuterik me qëllim që të përmbushen kërkesat e mjetit,
 - Të gjitha kërkesat e programit kompjuterik do të jenë të gjurmueshme për kërkesat e mjetit sipas pikës 2,

- - Validimi dhe verifikimi i programit kompjuterik, siç përcaktohet përkatësisht në pikat 5 dhe 6, do të aplikohen për një version të njohur të ekzekutueshëm të programit kompjuterik në mjedisin e tij operues.
- 5) Validimi i programit kompjuterik nënkupton procesin e sigurimit që programit kompjuterik të përmbushë kriteret për aplikimin e specifikuar ose përdorimin e interesuar të të dhënave aeronautike dhe informacionit aeronautik.
 - 6) Verifikimi i programit kompjuterik nënkupton vlerësimin e rezultatit (output) të një procesi të zhvillimit të softuerit mbi të dhënat aeronautike dhe informacionin aeronautik për të siguruar korrektësinë dhe përputhjen lidhur me të dhënat e regjistruara (inputet) dhe standardet e aplikueshme të programit kompjuterik, rregullat dhe marrëveshjet e përdorura në atë proces.

SHTOJCA VI

KERKESAT E MBROJTJES SË TË DHËNAVE SIPAS NENIT 9

- 1) Të gjitha të dhënat të transferuara në një format elektronik do të jenë të mbrojtura kundrejt humbjes apo alterimit të të dhënave nga zbatimi i algoritmit KCR32Q sipas pikës 21 të Shtojcës III të kësaj Rregulloreje. Vlera e Kontrollit Ciklik Rastesor (që këtej e tutje KCR) do të aplikohet para verifikimit final të të dhënave përpara ruajtjes ose transferimit.
- 2) Në rast se përmasat fizike të të dhënave tejkalojnë ato që mund të mbrohen në nivelin e kërkuar të integritetit nga një KCR e vetme, do të përdoren vlera të shumëfishta të KCR.
- 3) Të dhënave aeronautike dhe informacionit aeronautik do tu jepet një nivel i përshtatshëm në sigurinë e mbrojtjes gjatë ruajtjes dhe kur shkëmbehen mes palëve sipas Nenit 2(2), për të siguruar që të dhënat nuk mund të ndryshohen rastësisht ose nënshtrohen një aksesit të paautorizuar dhe/ose alterimi në asnjë fazë.
- 4) Ruajtja dhe transferimi i të dhënave aeronautike dhe informacionit aeronautik do të mbrohen nga një proces i përshtatshëm verifikimi në mënyrë të tillë që marrësit të mund të konfirmojnë që të dhënat ose informacioni është transmetuar nga një burim i autorizuar.

SHTOJCA VII

KERKESAT E MENAXHIMIT TË CILËSISË, SHMANGIES SE RREZIQEVE DHE SIGURISË SIPAS NENIT 10

PJESA A

Sistemi i menaxhimit të cilësisë

- 1) Një sistem i menaxhimit të cilësisë në mbështetje të krijimit, prodhimit, ruajtjes, përdorimit, përpunimit, transferimit dhe shpërndarjes së të dhënave aeronautike dhe informacionit aeronautik do të:
 - Përcaktojë politikën e cilësisë në një mënyrë të tillë që të përmbushë nevojat e përdoruesve të ndryshëm sa më mirë të jetë e mundur,
 - Krijojë një program për sigurimin e cilësisë që përmban procedurat e planifikuara për të verifikuar që të gjitha operacionet të kryhen në përputhje me kerkesat e zbatueshme, standardet dhe procedurat, duke përfshirë kerkesat përkatëse të kësaj Rregulloreje,
 - Sigurojë evidenca për funksionimin e sistemit të cilësisë me anë të manualeve dhe dokumenteve monitoruese,
 - Caktojë përfaqësues administrimi për të monitoruar përmbushjen dhe përshtatshmërinë e procedurave për të siguruar praktika operative të sigurta dhe efektive.
 - Kryejë kontrole të sistemit të cilësisë të vënë në veprim dhe do të ndërmarrë veprime korigjuese sipas rastit.
- 2) Një certifikatë EN ISO 9001, lëshuar nga një organizatë e akredituar, do të konsiderohet si një mjet i mjaftueshëm i përmbushjes së kriterëve të pikës 1. Palët sipas Nenit 2(2) do të pranojnë paraqitjen e dokumentacionit lidhur me certifikimin tek autoriteti mbikëqyrës kombëtar me kërkesë të këtij të fundit.

PJESA B

Objektivat e menaxhimit të shmangies së rreziqeve

- 1) Objektivat e menaxhimit të shmangies së rreziqeve do të:
 - minimizojnë kontributin në riskun e një aksidenti të një mjeti ajror që rrjedh nga gabime në të dhënat për aq sa është e mundshme në mënyrë të arsyeshme,
 - promovojnë ndërgjegjësimin e sigurisë në organizatë duke shpërndarë mësim lidhur me aktivitetet për shmangien e rreziqeve dhe duke përfshirë të gjithë stafin në propozimin e zgjidhjeve në çështje të identifikuara të sigurisë dhe përmirësimet për të asistuar në efektshmërinë dhe efikasitetin e proceseve,
 - sigurohen që brenda organizatës të identifikohet një funksion përgjegjës për zhvillimin dhe mirëmbajtjen objektivave të menaxhimit të shmangies së rreziqeve,
 - sigurojnë që mbahet dokumentacion dhe kryhet monitorim për të siguruar shmangien e rreziqeve në aktivitetet e tyre,
 - sigurojnë që të rekomandohen përmirësime, aty ku nevojiten, për të siguruar shmangien e rreziqeve në aktivitetet e tyre.
- 2) Arritja e objektivave të menaxhimit të shmangies së rreziqeve do të ketë prioritetin më të lartë kundrejt presioneve komerciale, operative, ambientale apo sociale.

PJESA C

Objektivat e menaxhimit të sigurisë

- 1) Objektivat e menaxhimit të sigurisë do të:
 - garantojnë sigurinë e të dhënave aeronautike dhe informacionit aeronautik të marrë, krijuar ose i përdorur në mënyrë që ato të jenë të mbrojtura nga interferencat dhe aksesit në to të jetë i kufizuar vetëm në personat e autorizuar.
 - sigurojnë që masat e menaxhimit të sigurisë të një organizate të përmbushin kërkesat e përshtatshme kombëtare dhe ndërkombëtare për infrastrukturën kritike dhe vazhdueshmërinë e biznesit, dhe standardet ndërkombëtare për administrimin e sigurisë, duke përfshirë standardet ISO sipas pikave 22 dhe 23 të Shtojcës III të kësaj Rregulloreje, për sa kohë ato janë pjesë e kuadrit rregullator në vendin tone..

- 2) Lidhur me standardet ISO, certifikata përkatëse e lëshuar nga një organizatë e akredituar, do të konsiderohet si një mjet i mjaftueshëm përmbushjeje. Palët sipas Nenit 2(2) do të pranojnë paraqitjen e dokumentacionit lidhur me certifikimin tek autoriteti mbikëqyrës kombëtar me kërkesë të këtij të fundit.

SHTOJCA VIII

Kerkesat për vlerësimin e konformitetit dhe përshtatshmërisë për përdorimin e elementeve përbërës sipas Nenit 11

- 1) Veprimet verifikuese do të tregojnë konformitetin e elementeve përbërës me ndërveprueshmërinë, performancën, kerkesat e cilësisë dhe sigurisë së kësaj Rregulloreje, ose përshtatshmërinë e tyre për përdorim ndërsa këta elementë përbërës janë aktiv në ambientin e testimit.
- 2) Prodhuesi, ose përfaqësuesi i tij i autorizuari vendosur në BE, do të administrojë aktivitetet e vlerësimit të konformitetit dhe në veçanti do të:
 - Përcaktojë mjedisin e përshtatshëm testues,
 - Verifikojnë që plani i testimit të përshkruajë elementët përbërës në ambientin e testimit,
 - Verifikojnë që plani i testimit të sigurojë një mbulim të plotë të kriterëve të aplikueshme,
 - Të sigurojnë konsistencën dhe cilësinë e dokumentacionit teknik dhe planit të testit,
 - Planifikojnë organizimin dhe stafin e testit, si edhe instalimin dhe konfigurimin platformës së testit,
 - Kryejnë inspektimet dhe testet siç specifikohet në planin e testit,
 - Shkruajnë raportin duke paraqitur rezultatet e inspektimeve dhe testeve.
- 3) Prodhuesi, ose përfaqësuesi i tij i autorizuar i vendosur në BE, do të sigurojë që përbërësit e përfshirë në krijimin, prodhimin, ruajtjen, përdorimin, përpunimin, transferimin dhe shpërndarjen e të dhënave aeronautike dhe informacionit aeronautik të integruar në ambientin e testit të përmbushin kriteret e ndër - veprueshmërisë, performancës, si edhe kriteret e cilësisë dhe sigurisë së kësaj Rregulloreje.
- 4) Pas plotësimit të kënaqshëm të verifikimit të konformitetit dhe përshtatshmërisë së përdorimit, Prodhuesi, ose përfaqësuesi i tij i autorizuar i vendosur në BE, në përgjegjësinë e tij do të hartojë deklaratën EC të konformitetit dhe përshtatshmërisë së përdorimit, duke specifikuar kryesisht kriteret e kësaj Rregulloreje të përmbushur nga clementi përbërës dhe kushtet e tij përkatëse të përdorimit sipas pikës 3 të Shtojcës III të Urdhrit të Ministrit të Transporteve Nr. 8 date 03.06.2010 “Për Ndërveprimin në Rrjetin Evropian të Menaxhimit të Trafikut Ajror”.

SHTOJCA IX

KUSHTET SIPAS NENIT 12

- 1) Ofruesi i shërbimeve të lundrimit ajror duhet të ketë të gatshme metoda raportuese brenda organizatës që sigurojnë dhe tregojnë paanësi dhe pavarësi të gjykimit në lidhje me aktivitetet e verifikimit.
- 2) Ofruesi i shërbimeve të lundrimit ajror duhet të sigurohet që personeli i përfshirë në proceset e verifikimit të kryejë kontrollet me integritetin më të madh profesional të mundshëm dhe kompetencën teknike më të madhe të mundshme, dhe të jenë të lirë prej çdo presioni apo incentivi, në veçanti të llojit financiar, që mund të ndikojë në gjykimin e tyre apo rezultatet e kontrollit të tyre, në veçanti nga persona apo grupe personash të prekur nga rezultati i kontrolleve.
- 3) Ofruesi i shërbimeve të lundrimit ajror duhet të sigurohet që personeli i përfshirë në proceset e verifikimit, të ketë akses tek pajisjet që i mundësojnë atyre të kryejnë në mënyrën e duhur kontrollet e kërkuara.
- 4) Ofruesi i shërbimeve të lundrimit ajror duhet të sigurohet që personeli i përfshirë në proceset e verifikimit, të ketë trajnim teknik dhe profesional të fortë, njohuri të kënaqshme mbi kriteret e verifikimeve që ata duhet të kryejnë, një eksperiencë të përshtatshme të këtyre veprimeve, dhe aftësinë e kërkuar për të hartuar deklarata, dokumente dhe raporte për të treguar që verifikimet janë kryer.
- 5) Ofruesi i shërbimeve të lundrimit ajror duhet të sigurohet që personeli i përfshirë në proceset e verifikimit, të jetë i aftë të kryejë kontrollet e tij me paanshmëri. Shpërblimi i tyre nuk do të varet nga numri i kontrolleve të kryera, apo nga rezultatet e këtyre kontrolleve.

SHTOJCA X

PJESA A

Kerkesat për verifikimin e sistemeve sipas nenit 12(1)

- 1) Verifikimi i sistemeve të identifikuara në nën-paragrafin e parë të Nenit 2(1) do të tregojë përshtatjen e këtyre sistemeve me kriteret e ndër veprueshmërisë, performancës dhe sigurisë së kësaj Rregulloreje në një mjedis vlerësimi që të pasqyrojë kontekstin operativ të këtyre sistemeve.

- 2) Verifikimi i sistemeve të identifikuara në nën-paragrafin e parë të Nenit 2(1) do të kryhet në përputhje me praktikat testuese të përshtatshme dhe të njohura.
- 3) Mjetet e testeve të përdorura për identifikimin e sistemeve të përcaktuara në nën-paragrafin e parë të Nenit 2(1) do të kenë funksione të përshtatshme.
- 4) Verifikimi i sistemeve të identifikuara në nën-paragrafin e parë të Nenit 22(1) do të hartojë elementet e një dosjeje teknike kërkuar nga pika 3 e Shtojcës IV të Urdherit të Ministrisë të Transporteve Nr. 8 date 03.06.2010 “Për Ndërveprimin në Rrjetin Evropian të Menaxhimit të Trafikut Ajror” duke përfshirë elementët vijues:
 - Përshkrimin e zbatimit,
 - Raportin e inspektimeve dhe testeve të arritura përpara vënies së sistemit në punë.
- 5) Ofruesi i shërbimeve të lundrimit ajror do të administrojë veprimet e verifikimit dhe në veçanti do të:
 - Përcaktojë ambientin e përshtatshëm simulues operativ dhe teknik që pasqyron ambientin operativ,
 - Verifikojë që plani i testit të përshkruajë integrimin e sistemeve të përcaktuara në nën-paragrafin e parë të Nenit 2(1) në një mjedis vlerësimi operativ dhe teknik,
 - Verifikojë që plani i testit të sigurojë një mbulim të plotë të kriterëve të zbatueshme të ndërveprueshmërisë, performancës dhe sigurisë të kësaj Rregulloreje,
 - Sigurojë konsistencën dhe cilësinë e dokumentacionit teknik dhe planin e testimit,
 - Planifikojë organizimin edhe stafin e testit si edhe instalimin e konfigurimin e platformës së testit,
 - Kryejë specifikimet dhe testet siç specifikohet në planin e testit,
 - Hartojë raportin duke paraqitur rezultatet e inspektimeve dhe testeve.
- 6) Ofruesi i shërbimeve të lundrimit ajror do të sigurojë që sistemet e përcaktuara në nën-paragrafin e parë të Nenit 2(1) nën përgjegjësinë e tij të përmbushin kriteret e ndërveprueshmërisë, performancës, si edhe kriteret e sigurisë së kësaj Rregulloreje.
- 7) Pas plotësimit të kënaqshëm të verifikimit të përshtatjes, ofruesi i shërbimeve të lundrimit ajror do të hartojnë deklaratën KE të verifikimit të sistemit dhe do t’ia paraqesë atë autoritetit mbikëqyrës kombëtar së bashku me dosjen teknike siç kërkohej në Nenin 6 të Urdherit të Ministrisë të Transporteve Nr. 8 date 03.06.2010 “Për Ndërveprimin në Rrjetin Evropian të Menaxhimit të Trafikut Ajror”.

PJESA B

Kerkesat për verifikimin e sistemeve sipas nenit 12(2)

- 1) Verifikimi i sistemeve të përcaktuar në nën-paragrafin e parë të Nenit 2(1) do të tregojë përshtatjen e këtyre sistemeve me kriteret e ndërveprueshmërisë, performancës, si dhe me kriteret e sigurisë së kësaj Rregulloreje në një mjedis vlerësimi që të pasqyrojë kontekstin operativ të këtyre sistemeve.
- 2) Verifikimi i sistemeve të përcaktuara në nën-paragrafin e parë të Nenit 2(1) do të kryhet në përputhje me praktikat testuese të përshtatshme dhe të njohura.
- 3) Mjetet testuese të përdorura për verifikimin e sistemeve të përcaktuara në nën-paragrafin e parë të Nenit 2(1) do të kenë funksione të përshtatshme.
- 4) Verifikimi i sistemeve të përcaktuara në nën-paragrafin e parë të Nenit 2(1) do të hartojë elemente të dosjes teknike të kërkuara nga pika 3 e Shtojcës IV të Urdherit të Ministrit të Transporteve Nr. 8 date 03.06.2010 ‘Për Ndërveprimin në Rrjetin Evropian të Menaxhimit të Trafikut Ajror’ duke përfshirë elementet vijuese:
 - Përshkrimin e zbatimit,
 - Raportin e inspektimeve dhe testeve të arritura përpara vendosjes së sistemeve në punë.
- 5) Ofruesi i shërbimeve të lundrimit ajror do të përcaktojë mjedisin vlerësues të përshtatshëm operativ dhe teknik që të pasqyrojë mjedisin operativ ndërsa aktivitetet e verifikimit do të kryhen nga një organ i njoftuar.
- 6) Organi i njoftuar do të administrojë aktivitetet e verifikimit dhe në veçanti do të:
 - Verifikojë që plani i testit të përshkruajë integrimin e sistemeve të përcaktuara në nën-paragrafin e parë të Nenit 2(1) në një mjedis vlerësimi operativ dhe teknik,
 - Verifikojë që plani i testit të sigurojë një mbulim të plotë të kritereve të zbatueshme të ndër-veprueshmërisë, performancës dhe sigurisë të kësaj Rregulloreje,
 - Sigurojë konsistencën dhe cilësinë e dokumentacionit teknik dhe planin e testimit,
 - Planifikojë organizimin edhe stafin e testit si edhe instalimin e konfigurimin e platformës së testit,
 - Kryejë specifikimet dhe testet siç specifikohet në planin e testit,
 - Hartojë raportin duke paraqitur rezultatet e inspektimeve dhe testeve.
- 7) Organi i njoftuar do të sigurohet që sistemet e përcaktuara në nën-paragrafin e parë të Nenit 2(1) të përdorura në një ambient vlerësimi operativ plotësojnë kriteret e ndër-veprueshmërisë, performancës dhe sigurisë të kësaj Rregulloreje.

- 8) Pas përmbushjes së kënaqshme të detyrave të verifikimit, organi i lajmëruar do të hartojë një certifikatë konformiteti në lidhje me detyrat e kryera.
- 9) Më pas ofruesi i shërbimeve të lundrimit ajror do të hartojë deklaratën KE të verifikimit të sistemeve dhe do t'ia paraqesë atë autoritetit të mbikëqyrjes kombëtare së bashku me dosjen teknike siç kërkohet në Nenin 6 të Urdherit të Ministrit të Transporteve Nr. 8 date 03.06.2010 "Për Ndërveprimin në Rrjetin Evropian të Menaxhimit të Trafikut Ajror".

SHTOJCA XI

DIFERENCAT NGA ICAO SIPAS NENIT 14

Kapitulli 3, Seksioni 3.2.10 (Kontrollit Ciklik Rastesor) i Udhëzimit të Ministrit të Transporteve Nr. 81, date 31.07.2012 "Për miratimin e rregullores mbi shërbimin e informacionit aeronautik".

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë).

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja "Kristalina"
Tiranë, 2014

Adresa
Bulevardi "Gjergj Fishta",
pas ish-Ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 376 lekë